



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2042/10 prot.,

Datë 09.08.2024

V E N D I M

Nr. 1017/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.08.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 973/2024, datë 30.07.2024 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-13183-07-15-2024 me objekt “Blerje kancelari, tonera për fotokopje dhe printerash”, me fond limit 1,416,666.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26-07-2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Bulqizë

Ankimues:

Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, me Nipt J62426002Q, Adresa: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Bulqizë
Adresa: Lagjja “Minatori”, Bulqizë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 30.07.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 973/2024, ku vendosi: [...]

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Infosoft Office" SHPK për procedurën e REF-13183-07-15-2024 me objekt "Blerje kancelari, tonera për fotokopje dhe printerash", me fond limit 1,416,666.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26-07 2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Bulqizë.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Infosoft Office" SHPK

5. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2042/7 prot., datë 07.08.2024, protokolluar me tonën dhe me nr. 3947/1 prot., datë 05.08.2024 autoriteti kontraktor, kërkon heqjen e procedurës nga pezullimi për të bërë anulimin dhe për të vijuar më tej me rihedhjen e procedurës në lote në zbatim të vendimit nr. 973/2024, datë 30.07.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2042/7 prot., datë 07.08.2024, protokolluar me tonën dhe me nr. 3947/1 prot., datë 05.08.2024 autoriteti kontraktor, me objekt "Informacion mbi zbatimin e vendimit" ku në përmbatje të saj kërkon heqjen e procedurës nga pezullimi për të bërë anulimin dhe për të vijuar më tej me rihedhjen e procedurës, në zbatim të vendimit nr. 973/2024, datë 30.07.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik.

"Mbështetur në ligjin nr 139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", Ligji nr 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 115, Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, Neni 118 Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe Vendimit të KPP -së nr. 973/2024 prot, datë 30.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 3947, datë 02.08.2024

Në lidhje me ankesën të Operatorit "INFOSOFT OFFICE" SHPK për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje kancelari, tonera për fotokopje dhe printerash" numër REF-13183-07-15-2024 Bashkia Bulqizë ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 973/2024 prot, datë 30.07.2024, protokolluar me tonën me nr 3947, datë 02.08.2024, duke lejuar AK që të kryej modifikimet e DST-së sipas

konstatimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të cilët nëpërmjet vendimit të tyre me datë 25.07.2024, ndër të tjera kanë vendosur :

Saktësimin e pretendimeve të tjera në lidhje me specifikimet teknike do të pasqyrohen në DST, në procedurën e re e cila do të ngarkohet në sistem, pas anulimit të procedurës në fjalë, referuar vendimit nr. 1 të KSHA-së referuar ankesave për të njejtin objekt prokurimi.

Sa më sipër vendimit procedura është anuluar që të rihidhet sërish me ndryshimet dhe saktësimet përkatëse.

Një kopje e vendimit i është dërguar dhe zyrës së financës për të kryer veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "INFOSOFT OFFICE" SHPK. ”.

II.2. Sa më sipër, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor kërkon heqjen e procedurës nga pezullimi për të bërë anulimin dhe për të vijuar më tej me rihedhjen e procedurës, në zbatim të vendimit nr. 973/2024, datë 30.07.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.3. Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1.Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për anulimin e procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-13183-07-15-2024 me objekt “Blerje kancelari, tonera për fotokopje dhe printerash”, me fond limit 1,416,666.00 lekëpa TVSH, zhvilluar më datë 26-07-2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Bulqizë.

2.Autoriteti kontraktor, me rishpalljen e procedurës së prokurimit, të reflektojë në dokumentet e tenderit arsyetimet dhe konstatimet e vendimit nr. 973/2024 datë 30.07.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

